



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 12 qershor 2017
Nr. ref.:RK 1089/17

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI50/15

Parashtrues

Florim Leci

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Pml.
nr. 230/2014, të 4 dhjetorit 2014**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga z. Florim Leci (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), me banim në fshatin Gmicë, komuna e Kamenicës. Parashtruesi i kërkesës përfaqësohet nga z. Shabi Sh. Isufi, avokat nga Gjilani.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Pml. nr. 230/2014, të 4 dhjetorit 2014, i cili i është dorëzuar më 18 dhjetor 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit PML. nr. 230/2014 të Gjykatës Supreme, me të cilin pretendohet të jenë shkelur neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe neni 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe neni 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet 22 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 17 prill 2015, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi nëpërmjet postës kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 20 prill 2015, kërkesa ishte regjistruar në Gjykatë.
7. Më 2 qershor 2015, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI50/15, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KI50/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Bekim Sejdiu.
8. Më 5 qershor 2015, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
9. Më 2 nëntor 2016, Kryetarja emëroi gjyqtarin Altay Suroy në vend të gjyqtarit Robert Carolan në Kolegjin shqyrtues.
10. Më 28 mars 2017, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 12 mars 2012, një person ishte vrarë dhe disa të tjerë ishin lënduar gjatë një vjedhjeje në një shtëpi private. Vjedhja ishte bërë nga disa persona.

12. Të njëjtën ditë, Njësia mjeko-ligjore e policisë kontrolloi vendin e ngjarjes dhe hartoi një raport.
13. Të njëjtën ditë, parashtruesi i kërkesës dhe dy persona të tjerë ishin marrë në paraburgim, të akuzuar për kryerjen e veprës penale.
14. Më 3 prill 2012, Prokurori i Qarkut mori në pyetje parashtruesin e kërkesës lidhur me grabitjen. Parashtruesi kërkoi që të bëhet analiza e ADN-së në njollat e gjakut dhe në rrobat e viktimave të të dyshuarve, në mënyrë që të mund të vërtetohet gjendja faktike (Procesverbali PPH. nr. 65/2012).
15. Më 11 qershor 2012, në seancën dëgjimore për vazhdimin e paraburgimit të tij, parashtruesi përsëriti kërkesën e tij për testin e ADN-së (Procesverbali PPR. nr. 27/12).
16. Më 8 tetor 2012, Prokuroria Publike e Qarkut ngriti aktakuzë (PP. nr. 65/2012) në Gjykatën e Qarkut në Gjilan kundër parashtruesit të kërkesës për kryerjen e veprës penale nga neni 256, paragrafi 2 [Rastet e rënda të vjedhjes grabitqare apo të grabitjes], në lidhje me nenin 23 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPPK).
17. Më 22 nëntor 2012, u mbajt seanca dëgjimore në të cilën u konfirmua aktakuza. Parashtruesi i kërkesës kërkoi testin e ADN-së në këtë seancë dëgjimore ku ishte konfirmuar aktakuza. Parashtruesi i kërkesës propozoi veçanërisht krahasimin e mostrave të gjakut të viktimës, të palës së dëmtuar dhe të të dyshuarve. Ky test do të ishte vendimtar, sipas parashtruesit të kërkesës, për të vërtetuar rrethanat e sakta faktike, duke pasur parasysh se ka kundërthënie esenciale ndërmjet deklaratave të bashkakuzuarve.
18. Të njëjtën ditë, Gjykata e Qarkut në Gjilan (Aktgjykimi P. (k. a.) nr. 171/12) konfirmoi aktakuzën e 8 tetorit 2012 (PP. nr. 65/2012). Në vendimin e saj, Gjykata e Qarkut në Gjilan nuk e adresoi kërkesën e parashtruesit për testin e ADN-së që ishte ngritur gjatë seancës dëgjimore.
19. Më 25 janar 2013, parashtruesi i kërkesës iu drejtua Gjykatës Themelore - Departamenti për Krime të Rënda, duke kërkuar një kontroll të drejtpërdrejt të tij nga një komision i ekspertëve mjekësor për të përcaktuar nëse një person që vuan nga tipi 1 i diabetit, në nivel të seriozitetit të parashtruesit të kërkesës, do të ishte fizikisht i aftë për të ndërmarrë veprimet e nevojshme për kryerjen e veprës penale.
20. Më 9 shkurt 2013, parashtruesi i kërkesës iu drejtua me një parashtrësë Prokurorisë Themelore - Departamenti për Krime të Rënda, duke kërkuar që parashtruesi i kërkesës të kontrollohet nga një komision i ekspertëve mjekësor për të përcaktuar rrethanat faktike të veprës penale.
21. Më 19 qershor 2013, Qendra Klinike Universitare e Kosovës (në tekstin e mëtejme: QKUK), siç ishte kërkuar nga Gjykata Themelore në Gjilan, dorëzoi në Gjykatën Themelore në Gjilan një raport mjekësor në lidhje me parashtruesin e kërkesës. Gjykata kërkoi nga Komisioni mjekësor që të japë mendimin e tyre profesional nëse personi i akuzuar (parashtruesi i kërkesës)

ishte në gjendje që të ndërmarrë veprime me të cilat ai është ngarkuar në aktakuzë, duke marrë parasysh edhe diagnozën mjekësore sipas të cilës ai është trajtuar.

22. Në raportin mjekësor theksohej, *inter alia*, si në vijim:

1. *“[Parashtruesi i kërkesës], i lindur më 27.03.1993, në tetor të vitit 2010 u diagnostikua me diabet të tipit I, një sëmundje e përjetshme, e cila kërkon aplikimin e insulinës në mënyrë të përhershme për mbijetesë, siç përshkruhet nga endokrinologu.*
2. *Sëmundja, kur kontrollohet mirë, mundëson aftësi të mira fizike dhe mendore. [...].*
3. *[...] Është e pamundur që të konkludohet se si ishte në kohën e veprës glukoza në gjak për shkak të një situatë stresuese dhe nëse ai ka marrë insulinë paraprakisht. Pasi që akti i vjedhjes në fjalë ishte i paramenduar dhe e përgatitur, është e vështirë të besohet se i akuzuari ka kryer veprën penale, pa marrë insulinë dhe pa e ditur nivelin e glukozës në gjak.*
4. *[Parashtruesi i kërkesës] pas 2 vjet me diabet dhe njohjes me hypoglycemia, duke përfshirë shenjat subjektive, duket se nuk ka gjasa që ai e ka vënë veten në një situatë të tillë. [...]*
5. *[...]”*

23. Më 9 shtator 2013, parashtruesi i kërkesës përsëri iu drejtua Gjykatës Themelore - Departamenti për Krime të Rënda me një parashtrësë, duke kundërshtuar raportin mjekësor të QKUK-së, me arsyetimin se ai nuk ishte kontrolluar drejtpërdrejt. Parashtruesi i kërkesës më tej kërkoi që Gjykata Themelore - Departamenti për Krime të Rënda të veprojë në përputhje me kërkesën e tij të 25 janarit 2013, për një ekzaminim të drejtpërdrejtë.

24. Më 13 shtator 2013, parashtruesi i kërkesës iu drejtua kryesuesit dhe anëtarëve të trupit gjykues të Gjykatës Themelore - Departamenti për Krime të Rënda (P. nr. 2006/12), duke kundërshtuar ekspertizën e kryer nga ana e QKUK-së për shkak se konkluzionet e raportit nuk janë të qëndrueshme dhe të bazuara duke pasur parasysh se parashtruesi i kërkesës nuk është kontrolluar drejtpërdrejt. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës në parashtrësën e tij drejtuar kryesuesit dhe anëtarëve të trupit gjykues të Gjykatës Themelore - Departamenti për Krime të Rënda (P. nr. 2006/12), përsëriti kërkesën e tij për testin e ADN-së, duke deklaruar se:

“[...] sipas propozimit të bërë të gjyqtarit i procedurës paraprake me datë 11.09.2012 patjetër, dhe propozimit të bërë më herët prokurorit me datë 03.04.2013, sepse shpjegimi se nuk ekzistojnë apo kanë humbur gjurmët, neve nuk na intereson, sepse ky shpjegim është jo i plotë dhe i paqëndrueshëm. I paqëndrueshëm është edhe shpjegimi se mungojnë provat vendimtare nga vendi i krimit, pasi prokuroria dhe policia duhet të japin shpjegim të qëndrueshëm dhe faktik. Mbrojtja nuk mund të kënaqet

në këtë rast me përgjigje se provat mungojnë dhe të heshtim para këtij shpjegimi të paqëndrueshëm, në momentin kur krimi fatkeqësisht është i rëndë, ndërsa të akuzuarit në deklaratimet e tyre kundërshtohen në mes vete.”

25. Më 23 dhjetor 2013, QKUK-ja, siç i ishte kërkuar nga Gjykata Themelore në Gjilan, dorëzoi në Gjykatën Themelore në Gjilan një raport mjeko-ligjor-psikiatrik në lidhje me parashtruesin e kërkesës. Gjykata kërkoj nga Komisioni i mjekëve që të japin mendimin e tyre nëse personi i akuzuar (parashtruesi i kërkesës) ishte në gjendje që të ndërmarrë veprime për të cilat ai është akuzuar në aktakuzë, duke marrë parasysh edhe diagnozën sipas së cilës ai trajtohet.
26. Në raport konstatohet *inter alia*, si më poshtë:
 1. *“Gjatë ekzaminimit psikiatrik ambulator, nuk është konstatuar se i njëjti vuan nga sëmundje mendore të karakterit të përhershëm ose të përkohshëm, nuk është konstatuar prapambetje mendore. Nuk është konstatuar ndonjë sëmundje tjetër mendore.*
 2. *[...]*
 3. *Sa i përket karakteristikave të personalitetit; I qetë, nuk manifeston iritabilitet, shqetësime të ndryshme. Është mjaft i penduar dhe kritik , për gjendjen”.*
 4. *Për veprën e cila i ngarkohet nuk konstatohet zvoglim i llogaritshmërisë.*
 5. *I njëjti mund të merr pjesë në seancë gjyqësore. Deponimet e tij janë valide “..*
 6. *[...]*
27. Më 27 dhjetor 2013, Gjykata Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda (Aktgjykimi P. nr. 206/2012) shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor për kryerjen e veprës penale nga neni 256, paragrafi 2 [Rastet e rënda të vjedhjes grabitqare apo të grabitjes], në lidhje me nenin 23 të KPPK-së.
28. Në lidhje me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për pamundësinë e kryerjes së veprës për shkak të tipit të tij I të diabetit, Gjykata Themelore konkuldoi se në bazë të raportit të hartuar nga QKUK-ja *“meqenëse akti i vjedhjes në fjalë ka qenë i paramenduar dhe i përgatitur është vështirë të besohet se [parashtruesi i kërkesës] ka shkuar për ta kryer veprën pa marrë insulinë dhe pa e ditur nivelin e glikemisë.”*
29. Gjykata, në seancën e shqyrtimit kryesor, dëgjoi palën e dëmtuar, dëshmitarët, dhe ekspertin e mjekësisë ligjore, shqyrtoi albumin e fotografive NJHR-0048/2012 të 12 marsit 2013, hartuar nga Njësia e Mjekësisë Ligjore nga vendi i ngjarjes dhe skicën e skenës së krimit; shqyrtoi albumin e fotografive të rindërtimit të vendit të ngjarjes dhe Raportin nr. NJHR-0048/12 Inspektimit të Skenës Penale, të 3 korrikut 2013; shqyrtoi CD-të e marra nga kamerat; lexoi

raportin e autopsisë, si albumin e fotografive MA. nr. 12/050 për rrëmbimin, të 12 marsit 2012; lexoi Raportin e Ekspertizës së Mjekësisë Ligjore për të dëmtuarin, hartuar nga Zyra e shërbimeve N. SH. Uka. nr. 028/050, të 2 tetorit 2012; lexoi Raportin e Ekspertizës së Mjekësisë Ligjore nr. 3539 të QKUK-së, Klinika Endokrinologjike, të 028/2013, për [parashtruesin e kërkesës]; lexoi Raportin nr. 257 të Klinikës Psikiatrike të QKUK-së për [parashtruesin e kërkesës], të 23 dhjetorit 2013.

30. Nga dëshmitë e dëshmitarëve, Gjykata Themelore konstatoi se *“[...] i shtrirë barkas kishte qenë një njeri e të cilin me duar ishte duke e goditur tani i ndjeri H. e ka dëgjuar të njëjtin person duke bërë titur “mos me sulmoni se jam i sëmurë nga sëmundja e sheqerit” e këtë fakt e kanë vërtetuar edhe e dëmtuara V. K. e cila ka deklaruar se e ka dëgjuar të dëmtuarin H. i cili ka cekur se personi i cili ishte aty më ka thënë “lëshomëni se jam i sëmurë prej sëmundjes së sheqerit” e të cilin fakt se vuan nga sëmundja e sheqerit nuk e ka mohuar edhe vetë [parashtruesi i kërkesës].”*
31. Gjykata Themelore vazhdon *“Gjykata gjithashtu e ka vlerësuar edhe mbrojtjen se [parashtruesi i kërkesës] nuk e ka mundur ta kryej edhe sikur të kishte dashur këtë veprë penale për shkak të sëmundjes së diabetit dhe nivelit të lartë të sheqerit se i njëjti i është nënshtruar edhe insulinës. Edhe një mbrojtje nuk është e mbështetur në asnjë provë materiale sepse nga Raporti mjekësor i QKUK në Klinika Endokrinologjike në Prishtinë është konstatuar se i [parashtruesi i kërkesës] është i diagnostifikuar me sëmundjen e sheqerit të tip 1 dhe se sëmundja e kontrolluar mirë mundëson aftësi të mira fizike dhe mentale dhe se akti i vjedhjes ka qenë i paramenduar dhe i përgatitur mirë është vështirë të besohet se [parashtruesi i kërkesës] të ketë shkuar për ta kryer veprën pa e marrë insulinën dhe pa e ditur nivelin e glikemisë. Andaj gjykata gjeti se një mbrojtje e këtillë e [parashtruesi të kërkesës] është e drejtuar vetëm e vetëm për t’iu shmangur përgjegjësisë penale dhe se në veprimet e [parashtruesit të kërkesës] ekzistojnë të gjitha tiparet e veprës penale të vjedhjes grabitqare apo të grabitjes nga neni 256 para. 2 lidhur me neni 23 të KPK-ës.”*
32. Kundër këtij aktgjykimi, parashtruesi ushtroi ankesë në Gjykatën e Apelit. Parashtruesi i kërkesës kontestoi refuzimin e Gjykatës Themelore të propozimit për analizën e ADN-së dhe pretendoi se ai *“ka bërë shkeljen esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 403 al.2 pika 1 dhe 2 të KPPPK-së.”*
33. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendoi shkelje të dispozitave të njëjta të KPPPK-së, sepse gjykata nuk e ka marrë parasysh propozimin e tij për formimin e një komisioni ekspertësh të endokrinologjisë për të kontrolluar drejtpërdrejt parashtruesin e kërkesës, në vend të raportit të ekspertëve që kanë dhënë mendimin e tyre pa kontrollim të drejtpërdrejtë.
34. Më 30 qershor 2014, Gjykata e Apelit (Aktgjykimi PAKR. nr. 261/2014) e refuzoi ankesën e parashtruesit dhe e vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore. Gjykata e Apelit konstatoi se secili pretendim individual i parashtruesit të kërkesës ishte i paqëndrueshëm për shkak se aktgjykimi i

gjykatës së shkallës së parë nuk kishte përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës penale apo shkelje të ligjit penal.

35. Sipas Gjykatës së Apelit, pretendimet në ankesë nuk qëndrojnë se analiza e ADN-së duhet të bëhet dhe se duhet të formohet ekipi konsultativ i mjekëve për konstatimin e gjendjes së parashtruesit të kërkesës me qëllim të konstatimit të drejtë të fakteve, nëse parashtruesi i kërkesës, me sëmundjen e tij - diabetin, mund të ketë ndërmarrë veprimet për të kryer veprë penale për të cilën është shpallur fajtor. Gjykata e Apelit arsyetoi se:

“[...] Kjo për arsye se janë kryer të dyja ekspertizat e në të cilën pretendon ankesa dhe sipas ekspertizave të kryera [...] nuk është kontestuese se i [parashtruesi i kërkesës], vuan nga sëmundja e sheqerit-tipi një, e cila sëmundje është e përrjetshme dhe sipas ekspertizës së njëjtë në veprimet e të akuzuarit në kryerjen e veprës penale e në prezencën e marrjes së insulinës, sëmundja kontrollohet mirë dhe aftësitë fizike dhe mentale janë të ruajtura dhe nuk mund të konkludohet se në momentin e kryerjes së veprës penale glikemia është ngritur për shkak të situatës në të cilën është gjendur [parashtruesi i kërkesës]. [...] ndërsa sa i përket analizës së ADN-së, ajo as që ka qenë e nevojshme dhe e domosdoshme që të kryhet për faktin se edhe kryesit e veprës penale [parashtruesi i kërkesës] dhe i mituri, si dhe i ndjeri dhe i dëmtuari, i cili ka pësuar lëndime të rënda trupore janë identifikuar dhe nuk ka pasur nevojë që të bëhet analiza e ADN-së sepse me këtë asgjë e re nuk kishte me u vërtetuar [...]”

36. Më 15 shtator 2014, parashtruesi i kërkesës parashtrroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme të Kosovës kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit.
37. Më 4 dhjetor 2014, Gjykata Supreme (Aktgjykimi PML. nr. 230/2014), refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë. Gjykata Supreme arsyetoi se shumica e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës kundër aktgjykimeve të kontestuarra *“[...] kanë të bëjnë me vërtetimin e gjendjes faktike, ndërsa konform dispozitës së nenit 432 par. 2 të KPPK kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk mund të paraqitet për këtë bazë ligjore.”*
38. Në lidhje me refuzimin e Gjykatës Themelore të kërkesës për analizë të ADN-së, Gjykata Supreme e Kosovës konstatoi se Gjykata Themelore në Gjilan *“i ka dhënë arsyet ligjore, dhe ato arsye bazohen në gjendjen faktike të vërtetuar gjatë procedurës së administrimit të provave dhe me të drejtë gjykata e shkallës së dytë i ka pranuar si të ligjshme.”*
39. Përveç kësaj, në lidhje me ekspertizën mjekësore, Gjykata Supreme gjeti se gjendja mendore dhe shëndetësore e parashtruesit ishte konstatuar nga mjekët e fushave përkatëse dhe, në bazë të këtyre raporteve të ekspertëve, është konstatuar se parashtruesi i kërkesës ishte në gjendje të ndërmarrë veprimet e nevojshme për kryerjen e veprës penale për të cilën është shpallur fajtor.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

40. Parashtruesi i kërkesës pretendon si në vijim:

1. Shkelje të nenit 31 të Kushtetutës:

Parashtruesi i kërkesës në mënyrë të posaçme pretendon se “[...] sipas provave që i dorëzohen Gjykatës Kushtetuese, rezulton se parashtruesi me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike dhe zbardhjes së të vërtetës në këtë rast penal, ka kërkuar që të bëhet analiza e ADN-së, detektori i së vërtetës, formimin e Konzoliumit mjekësor për vërtetimin e aftësisë fizike të parashtruesit të kërkesës për kryerjen e veprës për të cilën është gjykuar, e të cilat as Prokuroria, as Gjykata e shkallës së parë e as gjykatat tjera nuk i kanë përfillur, duke pretenduar përfundimin sa më të shpejtë të kësaj çështje penale, për çka nuk është vepruar si në rastet tjera në bazë të praktikës gjyqësore, dhe në këtë mënyrë janë cenuar në mënyrë flagrante e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.”

2. Shkelja e nenit 53 të Kushtetutës:

Veçanërisht, parashtruesi i kërkesës pretendon se “[...] të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e që në rastin konkret nuk është vepruar në këtë mënyrë, ngase të drejtat e palëve në procedurë janë të garantuara me Kushtetutë, dhe gjykata e vendit në rastin konkret është dashur t'i zbatoj dispozitat ligjore të cilat garantojnë barazinë e palëve, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, duke gjykuar në mënyrë të drejtë dhe të paanshme dhe duke vendosur lidhur me parashtrimet e parashtruesit të kërkesës në të gjitha fazat e procedurës dhe në të gjitha Gjykatat ku janë parashtruar ato.”

Pranueshmëria e kërkesës

41. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i ka plotësuar të gjitha kriteret e pranueshmërisë, të cilat përcaktohen me Kushtetutë, Ligj dhe me Rregullore të punës.

42. Gjykata duhet së pari të përcaktojë nëse parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh se:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

43. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se kërkesa është dorëzuar në Gjykatë nga një individ.

44. Përveç kësaj, në pajtim me nenin 49 të Ligjit, parashtruesi i kërkesës duhet të parashtrojë kërkesën brenda katër (4) muajsh pas aktgjykimit të formës së prerë të Gjykatës. Më 4 dhjetor 2014, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin PML. nr. 230/14, ndërsa aktgjykimi i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 18 dhjetor 2014. Parashtruesi e ka dërguar kërkesën me postë në Gjykatë më 17 prill 2015. Prandaj, parashtruesi ka respektuar afatin e nevojshëm për paraqitjen e një kërkesë në Gjykatë.
45. Përveç kësaj, Gjykata Supreme konsiderohet si gjykatë e shkallës së fundit për të gjykuar çështjen në këtë procedurë penale. Si rezultat, Gjykata gjithashtu konstaton se parashtruesi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion të tij sipas ligjit të Kosovës.
46. Në fund, neni 48 i Ligjit përcakton se: *“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”*
47. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, me të cilin ai pretendon se i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës dhe neni 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së. Prandaj, parashtruesi e ka përmbushur edhe këtë kërkesë.
48. Megjithatë, Gjykata, gjithashtu, merr parasysh rregullat 36 (1) (d) dhe 36 (2) të Rregullores së punës, të cilat parashohin që:
- “(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*
- [...]*
- (d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.*
- (2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
- (a) kërkesa nuk arsyetohet prima facie, ose*
(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose
(c) Gjykata gjen që parashtruesi nuk është subjekt i ndonjë shkeljeje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë; ose
(d) Dhe parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”
49. Gjykata vëren se pretendimi i parashtruesit të kërkesës ka të bëjë me mënyrën në të cilën gjykatat e ndryshme të fakteve kanë trajtuar provat në procedurën kundër tij. Pretendimi kryesor i parashtruesit të kërkesës ka të bëjë me refuzimin e vazhdueshëm të gjykatave të rregullta që të autorizojnë një analizë të ADN-së dhe një ekzaminim mjekësor të drejtpërdrejtë të tij në mënyrë që të verifikohet gjendja faktike e ngjarjeve.

50. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, ku, në paragrafin e katërt, parashihet se:

“4. Çdokush i akuzuar për vepër penale ka të drejtë t’u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.”

51. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së e cila, në paragrafin e tretë të saj, përcakton se:

“3. Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme:

[...]

(d) të pyes ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës;”

52. Gjykata vëren se neni 6 (3. d) përbëhet prej tri elementeve të ndryshme, përkatësisht: a) të drejtën për të kontestuar dëshmitarët e prokurorisë (apo për të verifikuar provat tjera të paraqitura nga prokuroria në mbështetje të çështjes së tyre); b) të drejtën, në rrethana të caktuara, për të thirrur dëshmitar sipas zgjedhjes së dikujt për të dëshmuar në gjykim, p.sh. dëshmitarë të mbrojtjes; dhe c) të drejtën për të marrë në pyetje dëshmitarët e prokurorisë në të njëjtat kushte si ato që u ofrohen dëshmitarëve të mbrojtjes.

53. Gjykata rikujton se në pajtim me praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ), se *“si një rregull i përgjithshëm, gjykatat vendore duhet t’i vlerësojnë provat përpara tyre si dhe rëndësinë e provave të cilat të pandehurit kërkojnë që të paraqiten. Më konkretisht, neni 6 para. 3 (d) (neni 6-3-d) u lë atyre, përsëri si rregull i përgjithshëm, të vlerësojnë nëse është e përshtatshme që të thërrasin dëshmitarë, në kuptimin e ‘pavarësisë’ dhënë asaj fjale në sistemin e Konventës; ‘nuk kërkon praninë dhe marrjen në pyetje të çdo dëshmitari në emër të të akuzuarit: qëllimi i saj thelbësor, siç tregohet nga fjalët ‘në kushte të njëjta’ është ‘barazia e plotë e armëve’, në këtë çështje’. [...] Detyra e Gjykatës Evropiane është të konstatojë se a kanë qenë procedurat e drejta në çështjen, e konsideruar si një tërësi, siç kërkohet nga paragrafi 1 (neni 6-1)”. (Shih Vidal kundër Belgjikës, kërkesa nr. 12351/86, Aktgjykimi i 22 prillit 1992).*

54. Për më tepër, në Aktgjykimin e GJEDNJ-së në rastin e V. D. (Shih, V. D. kundër Rumanisë, Kërkesa nr. 7078/02, Aktgjykimi i 28 qershorit 2010), një shtetas rumun u dënua me 10 (dhjetë) vjet burgim për dhunim, 5 (pesë) vjet për incest dhe 6 (gjashtë) muaj për grabitje të armatosur. Vendimi ishte bazuar kryesisht në deklaratat e dhëna në polici nga gjyshja e parashtruesit dhe nga fqinji i saj. Më tej, vendimi u bazua në deklaratat e pesë dëshmitarëve indirekt dhe në një raport mjeko-ligjor që nuk kishte përfshirë testin e ADN-se, pavarësisht kërkesave të parashtruesit për këtë.

55. Në këtë rast, GJEDNJ-ja gjeti se “një test i ADN-së do të konfirmonte të paktën versionin e ngjarjeve të viktimës apo do t'i ofronte V. D. informacione të konsiderueshme në mënyrë që të dëmtonte besueshmërinë e rrëfimit së saj. Megjithatë, gjykatat nuk kishin autorizuar asnjë provë të tillë”. GJEDNJ-ja konstatoi, me tej, se “këtu kishte edhe mangësi tjera në hetimet e bëra më 1 prill 2001, përfshirë edhe dështimin e policisë për të kërkuar gjurmët e sulmit në vendin e ngjarjes”. Rrjedhimisht, GJEDNJ-ja konstatoi se ka pasur shkelje të nenit 6 (1) dhe (3. d) të KEDNJ-së.
56. Në pajtim me arsyetimin e lartcekur, Gjykata vëren se parimi i “barazisë së armëve” kërkon që secilës palë t'i jepet një mundësi e arsyeshme për të paraqitur rastin e saj, nën kushtet që nuk e vendosin atë në një pozitë të pafavorshme *vis-a-vis* një pale tjetër. Edhe pse nuk ka asnjë përkufizim shterues se cilat janë kërkesat minimale të “barazisë së armëve”, duhet të ketë garanci adekuate procedurale të përshtatshme për natyrën e rastit dhe që korrespondon me atë që është në pyetje ndërmjet palëve. Këtu mund të përfshihen mundësitë për të paraqitur dëshmi.
57. Sa i përket kësaj, Gjykata vëren se, refuzimi nga një gjykatë që të emërojë një ekspert, të dëgjojë një dëshmitar, ose të pranojë lloje të tjera të provave në rrethana të caktuara, mund ta bëjnë procedurën të padrejtë, përveç nëse kufizimet e tilla janë në përputhje me parimin e “barazisë së armëve”, zbatimi i plotë i të cilit është qëllimi thelbësor i nenit 6 (3) (d) të KEDNJ-së dhe, gjithashtu, i nenit 31 të Kushtetutës.
58. Më tej, personat që pretendojnë shkeljen e nenit 6 (3) (d) të KEDNJ-së, duhet të dëshmojnë që jo vetëm se atyre nuk u lejohej për të thirrur një dëshmitar të caktuar, por edhe se dëgjimi i dëshmitarit ishte absolutisht i nevojshëm në mënyrë që të konstatohej e vërteta dhe se dështimi për të dëgjuar dëshmitarin i cenoi të drejtat e mbrojtjes dhe ndershmërinë e procedurës në tërësi.
59. Në këtë drejtim, pyetja para kësaj Gjykate është nëse gjykatat e rregullta kishin shkelur të drejtën kushtetuese të parashtruesit “[...] që t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë të cilët mund të sqarojnë faktet”. Megjithatë, nuk është kompetencë e kësaj Gjykate që të përcaktojë nëse sipas ligjit kishte prova të mjaftueshme që të konstatohej se parashtruesi i kërkesës ishte fajtor për krim. Gjykata vetëm kërkon të përcaktojë nëse gjykatat e rregullta kishin shkelur të drejtat e parashtruesit në mënyrë procedurale në pajtim me Kushtetutën.
60. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se nga praktika gjyqësore e lartpërmendur ekzistojnë pesë kritere që zbatohen për të përcaktuar nëse, një refuzim i një kërkesë nga ana e mbrojtjes për të dëgjuar një dëshmitar ka ndikuar nëse procedurat si tërësi kanë qenë të drejta apo jo. Këto kritere janë si në vijim:
- (1) kërkesa për dëshmitar nuk është joserioze;
 - (2) kërkesa për dëshmitar është e arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme;

- (3) kërkesa për dëshmitar është relevante për objektin e çështjes së akuzës;
- (4) kërkesa për dëshmitar me siguri forcon pozicionin e mbrojtjes apo edhe mund të çojë në lirim; dhe
- (5) arsyet relevante janë dhënë nga gjykata për refuzimin e kërkesës për dëshmitar.
61. Sa i përket kriterit të parë, Gjykata vëren se kërkesat e bëra nga parashtruesi ishin logjikisht në përputhje me akuzat dhe ngjarjet faktike të përshkruara nga dëshmia e dëshmitarëve okularë dhe janë ngritur gjatë procedurës gjyqësore për të ndërtuar një rast për mbrojtje për shkak të veprës së ngarkuar. Për këtë arsye, Gjykata nuk e konsideron joserioze kërkesën e parashtruesit për dëshmitar ekspert.
62. Në lidhje me kriterin e dytë, Gjykata vëren se parashtruesi ka parashtruar kërkesën për një ekzaminim mjekësor të drejtpërdrejtë nga një ekspert profesional mbi bazat e mëposhtme: *“Kryerja e kësaj ekspertize është propozuar pasi që [parashtruesi] është i sëmurë rëndë nga diabeti, një fakt që është i njohur nga Prokuroria, dhe për më tepër [parashtruesi i kërkesës] në të gjitha fazat e procedurës hetimore ka mohuar kryerjen e veprës penale për të cilën ai akuzohet, ndërsa në anën tjetër ekzistojnë kundërthënie midis [parashtruesit të kërkesës] dhe të pandehurit të mitur.”*
63. Sa i përket kërkesës për analizë të ADN-së, propozimi i parashtruesit ishte bërë për arsyet në vijim: *“[...]” gjatë të gjitha fazave të procedurës kam propozuar që të bëhet ADN duke krahasuar mostrat e gjakut të viktimës dhe të dëmtuarit me mostrat e gjakut të të dyshuarit [...] dhe konsideroj se është me rëndësi vitale për vërtetimin e drejtë faktike sepse tani [parashtruesit të kërkesës] por edhe i mituri [...] kemi kundërshtime të mëdha në mes veti.”*
64. Në këto rrethana, Gjykata konstaton se kërkesat e parashtruesit për dëshmi shtesë të dëshmitarëve ekspertë ishin arsyetuar mjaftueshëm.
65. Për sa i përket kriterit të tretë, Gjykata konkludon se kërkesat për kontrollimin e drejtpërdrejtë dhe analizën e ADN-së janë të rëndësishme për objektin e çështjes së akuzës në çështjen penale, pasi që parashtruesi i kërkesës kërkoi nga ajo që të dëshmojë se ai nuk ishte në gjendje për të ndërmarrë veprimet me të cilat ai ishte akuzuar dhe nga kjo e fundit që të konfirmojë identitetin e kryesit të vërtetë të veprës penale.
66. Sa i përket kriterit të katërt, Gjykata konsideron se kërkesat e parashtruesit për ekspertët profesional për të kryer një ekzaminim të drejtpërdrejtë mjekësor dhe testin e ADN-së mund të kishin luajtur një rol të rëndësishëm në forcimin e pozitës së mbrojtjes së parashtruesit të kërkesës apo edhe për të çuar në lirimin e tij (shih, *inter alia*, *Dorokhov kundër Rusisë*, Kërkesa nr. 66802/01, Aktgjykimi i 14 shkurtit 2008), duke qenë se gjykata penale është e obliguar me parimin *in dubio pro reo* (shih *Melich dhe Beck kundër Republikës Çeke*, Kërkesa nr. 35450/04, Aktgjykimi i 24 korrikut 2008).

67. Në lidhje me kriterin e fundit, Gjykata vëren se gjykata e shkallës së parë, duke refuzuar qartë kërkesën për analizën e ADN-së, nuk arriti të sigurojë arsyetimin përkatës për vendimin e saj për të refuzuar kërkesën e parashtruesit. Për më tepër, Gjykata vëren se gjykata e shkallës së parë nuk e ka adresuar kërkesën e parashtruesit për një kontroll të drejtpërdrejtë nga një komision i ekspertëve mjekësor, duke u mbështetur në vend të kësaj në raportin e endokrinologëve të QKUK-së, të cilët dhanë mendimin e tyre profesional në bazë të shkresave të lëndës. Prandaj, Gjykata konsideron se ekspertiza mjekësore kishte shprehur një mendim për statusin e personave në situata të ngjashme siç është ajo e parashtruesit të kërkesës, por nuk dhanë një mendim për gjendjen e saktë të parashtruesit të kërkesës.
68. Megjithatë, Gjykata vëren se gjykata e shkallës së dytë kishte adresuar kërkesën e parashtruesit për një ekspertizë mjekësore dhe për provën e ADN-së.
69. Lidhur me kërkesën për kontroll të drejtpërdrejt të parashtruesit të kërkesës, gjykata e shkallës së dytë arsyetoi se *“[...] në bazë të ekspertizës së kryer [...], nuk është kontestuese se [parashtruesi i kërkesës], vuan nga sëmundja e sheqerit-tipi një, e cila sëmundje është e përrjetshme, dhe sipas ekspertizës së njëjtë ne veprimet e [parashtruesit të kërkesës] në kryerjen e veprës penale e në prezencën e marrjes së insulinës, sëmundja kontrollohet mirë dhe aftësitë fizike dhe mentale janë të ruajtura dhe nuk mund të konkludohet se në momentin e kryerjes së veprës penale glikemia është ngritur për shkak të situatës në të cilën është gjendur [parashtruesi i kërkesës].”*
70. Sa i përket kërkesës për dëshmitë e ADN-së së njollave të gjakut, gjykata e shkallës së dytë arsyetoi se ka pasur një sasi të madhe të dëshmive tjera vërtetuese ashtu që *“sa i përket analizës së ADN-së, ajo as që ka qenë e nevojshme dhe e domosdoshme që të kryhet për faktin se edhe kryesit e veprës penale [parashtruesi i kërkesës] dhe i mituri, si dhe i ndjeri dhe i dëmtuari, i cili ka pësuar lëndime të rënda trupore janë identifikuar dhe nuk ka pasur nevojë që të bëhet analiza e ADN-së, sepse me këtë asgjë e re nuk kishte me u vërtetuar, e në prezencën e provave të nxjerra në shqyrtimin gjyqësor, dëgjimit të dëshmitarëve, foto dokumentacionit, përgjimeve telefonike, të shikimit të bërë në CD, incizimet të marrura nga NTP “Toqi” në Malishevë, nga ekspertizat e ekspertëve endokrinolog dhe internistë, nga ekspertiza e neuropsikiatrisë, si dhe nga ekspertiza e ekspertit mjeko ligjor [...].”*
71. Në këto rrethana, Gjykata konstaton se gjykatat e rregullta kanë arsyetuar vendimet e tyre për të hedhur poshtë kërkesat e parashtruesit për testin e ADN-së dhe ekzaminim të drejtpërdrejtë mjekësor, për shkak se gjykatat e rregullta konsideruan se kishin prova të mjaftueshme të tjera në dispozicion për të mbështetur vendimin e tyre.
72. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka mbështetur pretendimet e tij për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë për shkak të lëshimit të gjykatave të rregullta që të kryejnë një test të ADN-së në njollat e gjakut te rrobat e viktimës dhe të parashtruesit të kërkesës, së bashku me vendimin e gjykatave të rregullta që ta refuzojnë kërkesën e parashtruesit për një ekzaminim mjekësor të drejtpërdrejtë.

73. Në përfundim, Gjykata konsideron se kërkesa e parashtruesit nuk i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë, të parapara më tutje me Ligj dhe të specifikuara me Rregullore të punës.
74. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullat 36 (1) (d) dhe 36 (2) (d) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE


Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7, paragrafët 1 dhe 7 të Kushtetutës, neneve 46 dhe 48 të Ligjit dhe rregullave 36 (1) (d) dhe 36 (2) (d) të Rregullores së punës, në seancën e saj të mbajtur më 28 mars 2017, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Ivan Čukalović



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

